



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____._____.2021

PËR

REZERVAT MATERIALE TË SHTETIT

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Ky ligj ka për qëllim krijimin e rezervave materiale të shtetit.
2. Ligji rregullon funksionimin e marrëdhënieve juridike që lindin gjatë krijimit dhe administrimit të rezervave materiale të shtetit, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve administruese, si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjekteve apo institucioneve që bashkëpunojnë për krijimin dhe administrimin e tyre.

Neni 2

Përkufizime

1. “Administrim” është shpërndarja, shkëmbimi, zëvendësimi, freskimi, plotësimi, mirëmbajtja, ruajtja, seleksionimi, huadhënia, blerja, shitja dhe çdo veprim tjetër që mund të kryhet me rezervat materiale të shtetit.
2. “Emergjencë civile” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për mbrojtjen civile.
3. “Fatkeqësi” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për mbrojtjen civile.
4. “Fatkeqësi natyrore” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për mbrojtjen civile.

5. “Fatkeqësi të tjera” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për mbrojtjen civile.
6. “Freskim” është zëvendësimi i detyrueshëm i një sasive malli që është në limitet e kohëruajtjes ose kur paraqet rrezik zhvlerësimi cilësor me mall të të njëjtës natyrë dhe lloj, duke ruajtur të pandryshuar sasinë, cilësinë dhe vlerën financiare të mallit që zëvendësohet.
7. “Gatishmëri” është gjendja e përkohshme që parashikon marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH) për t’iu përgjigjur menjëherë në çdo kohë një thirrjeje ose për të kryer një detyrë në funksion të krijimit dhe administrimit të rezervave materiale të shtetit.
8. “Gjendja e fatkeqësisë natyrore” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për mbrojtjen civile.
9. “Gjendja orientuese” është sasia maksimale e caktuar, e shprehur në njësi matëse, mbi të cilën nuk vlerësohet e nevojshme për shtetin të krijohen dhe mbahen artikuj të posaçëm.
10. “Huadhënia” është dhënia në përdorim të përkohshëm pa kundërshtpërblim e një apo disa mallrave të rezervës materiale të shtetit, në përputhje me normat e së drejtës civile që rregullojnë institutin e huapërdorjes.
11. “Krizë humanitare” është një ngjarje ose seri ngjarjesh në një zonë të caktuar e më gjerë, që janë kërcënuese për sa i përket shëndetit, sigurisë ose mirëqenies së një komuniteti ose një grupi të madh njerëzish dhe nuk mund të kontrollohet me resurse dhe masa të zakonshme.
12. “Limiti minimal” është sasia e caktuar, e shprehur në njësi matëse, nën të cilën nuk lejohet të bjerë sasia e një artikulli të posaçëm.
13. “Mallra ndihmë humanitare” janë mallrat që dhurohen si ndihmë materiale ose logjistike të dhëna për qëllime humanitare, në përgjigje ndaj kërkesës për ndihmë humanitare, përfshirë fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
14. “Mallra të konfiskuara” janë mjetet e punës, lëndët e para, materialet, karburantet, mjetet motorike, mjetet lundruese, produktet e gatshme, vlerat e tjera materiale dhe të gjitha sendet, pronësia e të cilave kalon në favor të shtetit, me vendim të formës së prerë të organit kompetent, si rrjedhojë e kundërvajtjeve administrative, veprave penale apo nga veprimet për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, të cilat administrohen në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
15. “Mallra të sekuestruara” janë mjetet e punës, lëndët e para, materialet, karburantet, mjetet motorike, mjetet lundruese, produktet e gatshme, vlerat e tjera materiale dhe të gjitha sendet, të cilat si pasojë e një procedimi të papërfunduar penal, organi kompetent ka vendosur ose ka urdhëruar sekuestrimin dhe ruajtjen e tyre në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit deri në përfundim të procesit.
16. “Ministri” është ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit.
17. “Ministria” është ministria përgjegjëse për rezervat materiale të shtetit.
18. “Mirëmbajtje” është bashkësia e të gjithë veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me administrimin e rezervave materiale të shtetit dhe subjekteve ekonomike të kontraktuara, me qëllim përkujdesjen efektive të rezervave materiale të shtetit.
19. “Plotësim” është shtimi i sasisë së rezervës materiale të shtetit deri në masën e gjendjes orientuese.

20. “Rezervat materiale të shtetit” janë lëndët e para, materialet, produktet e gatshme, prodhimet dhe mjetet e tjera të domosdoshme për depozitim, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tyre.
21. “Ruajtje” është veprimi i magazinimit fizik të një malli apo sasive mallrash që përjashton subjektin magazinues nga mbajtja e të drejtave të administrimit mbi këtë mall.
22. “Seleksionim” është veprimi administrativ që kryhet kur vlera e pronës nuk i shërben më qëllimit, sipas këtij ligji.
23. “Subjekte ekonomike”, në kuptim të këtij ligji, janë persona juridikë, privatë ose publikë, të cilët hyjnë në marrëdhënie kontraktore me institucionet përgjegjëse për rezervat materiale të shtetit në funksion të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së mallrave.
24. “Shkëmbim” është ndërrimi i një sasive malli me mall të një natyre dhe lloji tjetër, në cilësinë dhe sasinë e kërkuar, duke ruajtur të pandryshuar vlerën financiare të saj dhe standardet.
25. “Shpërndarje” është dhënia, falas ose me pagesë, e rezervave materiale të shtetit.
26. “Zëvendësim” është përtëritja e një sasive malli me mall të njëjtës natyrë dhe lloj, duke ruajtur të pandryshuar sasinë, si dhe pa ulur nivelin e cilësisë dhe vlerës financiare të mallit që përtërihet.

KREU II

KRIJIMI DHE PËRDORIMI I REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

Neni 3

Krijimi

Rezervat materiale të shtetit krijohen nga:

- a) Buxheti i shtetit;
- b) donacione apo burime të tjera që i lejon ligji;
- c) ndihmat humanitare;
- ç) konfiskimet;
- d) asetet që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

Neni 4

Grupimi

1. Mallrat rezervë materiale të shtetit grupohen për nga natyra, funksioni dhe rëndësia në mallra të grupit A, mallra të grupit B dhe mallra të grupit C.
2. Lista përbërëse e mallrave rezervë, në lloj, limit minimal dhe gjendje orientuese, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.
3. Nomenklatura, limiti minimal, gjendja orientuese dhe gjendja faktike e mallrave rezervë materiale shtetërore përbëjnë të dhëna konfidenciale.

Neni 5

Përdorimi

1. Rezervat materiale të shtetit përdoren për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e vendit, të popullsisë, të ekonomisë, të pasurisë, të shëndetit, të gjësë së gjallë dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Shqipërisë, në këto raste:
 - a) në situata të gjendjes së jashtëzakonshme;
 - b) në situata të gjendjes së fatkeqësisë natyrore ose fatkeqësive të tjera;
 - c) në situata të krizës humanitare;
 - ç) kur ndodhin fatkeqësi apo aksidente të veçuara të paparashikuara, që përbëjnë rrezik apo kanë dëmtuar një ose disa familje;
 - d) për t'u ardhur në ndihmë institucioneve të përkujdesjes sociale dhe personave juridikë publikë a privatë jofitimprurës, të cilët ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut, kur kjo vlerësohet e përshtatshme;
 - dh) për t'u ardhur në ndihmë institucioneve publike me mallra që iu nevojiten në zhvillimin e aktivitetit administrativ, kur kjo vlerësohet e përshtatshme.
2. Rezervat materiale të shtetit përdoren për dhënien e ndihmave humanitare në favor të shteteve të tjera për parandalimin dhe përbalimin e situatës së krijuar nga fatkeqësitë, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare.
3. Për rastet e parashikuara në pikat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të paragrafit 1, të nenit 5 të këtij ligji, shpërndarja bëhet me kërkesë të AKMC-së ose nga KNEC-ja, sipas rastit.

KREU III
INSTITUCIONET E ADMINISTRIMIT TË REZERVAVE
MATERIALE TË SHTETIT

Neni 6

Institucionet e administrimit të rezervave materiale të shtetit

Institucionet e administrimit të rezervave materiale të shtetit janë:

- a) Kryeministri;
- b) Ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit;
- c) Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

Neni 7

Kryeministri

Kryeministri miraton zbatimin e politikave strategjike të administrimit të rezervave materiale të shtetit dhe ushtron funksionet, si vijon:

- a) miraton strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe organizimin territorial të saj;
- b) miraton shpërndarjen, transferimin dhe shitjen e mallrave rezervë të grupit A
- c) miraton dhënien e mallrave ndihmë humanitare, sipas paragrafit 7, të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 8

Ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit

Ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit ushtron funksionet, si vijon:

- a) harton politikat strategjike dhe vendos objektivat kryesorë të administrimit të rezervave materiale të shtetit;

- b) i propozon Kryeministrin shpërndarjen, transferimin dhe shitjen e mallrave të grupi A;
- c) miraton shpërndarjen, transferimin dhe shitjen e mallrave të grupit B;
- ç) miraton udhëzimet përkatëse për procedurat dhe rregullat për shpërndarjen, transferimin dhe shitjen e mallrave të grupit B dhe C;
- d) i propozon Kryeministrin dhënie e mallrave ndihmë humanitare, sipas paragrafit 7, të nenit 14 të këtij ligji;

Neni 9

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH) është person juridik publik qendror në varësi të ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit, i ngarkuar me administrimin e rezervave materiale të shtetit.
2. DPRMSH-ja organizohet si drejtori e përgjithshme në nivel qendror me seli në Tiranë dhe nivel rajonal, në funksion të politikave kryesore, objektivave dhe efikasitetit në realizimin e detyrave.
3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të DPRMSH-së miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.
4. Struktura dhe organika e DPRMSH-së, në nivel qendror dhe rajonal miratohet me urdhër të Kryeministrin, me propozim të ministrit.
5. Nëpunësit e DPRMSH-së, në nivel qendror dhe rajonal, gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Marrëdhëniet e punës për nëpunësit civil, në nivel qendror dhe rajonal, rregullohen sipas legjislacionit për statusin e nëpunësit civil ndërsa marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë, në nivel qendror dhe rajonal, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 10

Funksionet e DPRMSH-së

DPRMSH-ja ushtron funksionet dhe ka përgjegjësitë, si vijon:

- a) zbaton politikat dhe objektivat kryesore të vendosur për administrimin e rezervave materiale të shtetit;
- b) ndjek procedurat për shpërndarjen e mallrave rezervë materiale shtetërore, sipas grupeve;
- c) informon periodikisht Kryeministrin, ministrin dhe kur i kërkohet, AKMC-në dhe KNEC-në mbi gjendjen faktike të nomenklaturës së rezervave materiale të shtetit;
- ç) krijon rezervat materiale të shtetit së paku në masën e limitit minimal dhe propozon politika financiare dhe administrative, me qëllim plotësimin e mallrave;
- d) bashkëpunon me AKMC-në dhe strukturat qendrore e vendore të mbrojtjes civile për të koordinuar punën dhe ndërhyrjen në mënyrë operative me mallra për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe shëndetit;
- dh) merr masa për përmirësimin e kushteve dhe mjediseve magazinuese, me qëllim mirëmbajtjen e mallrave rezervë materiale të shtetit;
- e) mbikëqyr dhe drejton drejtoritë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit në linjë me politikat strategjike të vendosura;
- ë) zhvillon procedurat administrative dhe tekniko-ligjore të shpërndarjes së mallrave, sipas pikës “b”, të nenit 7, pikës “c”, të nenit 8 dhe pikës “d”, të nenit 11 të këtij ligji;

- f) administron mallrat e konfiskuara dhe gjeneron të ardhura për shtetin nga shitja me procedura të ankandit publik të mallrave që vlerësohet se nuk i shërbejnë funksionit parësor të institucionit;
- g) hyn në marrëdhënie kontraktore me subjekte ekonomike për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e mallrave;
- gj) bashkëpunon me organet kompetente që kanë vendosur ose kanë urdhëruar ruajtjen deri në përfundim të procesit administrativ ose penal të mallrave të sekuestruar dhe u propozon atyre sipas rastit të urdhërojnë ose të vendosin kryerjen e një veprimi administrimi të mallit;
- h) analizon në mënyrë periodike tregun në funksion të efikasitetit në bashkëpunimin me subjektet ekonomike private, si dhe zhvillon aktivitete informuese, dialoguese dhe shkëmbime eksperiencash në këtë kuadër.

Neni 11

Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit

1. Drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit drejton veprimtarinë e përditshme, sipas objektivave të vendosura për administrimin e rezervave materiale të shtetit.
2. Drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit mban përgjegjësitë, si vijon:
 - a) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e DPRMSH-së;
 - b) përfaqëson DPRMSH-në në marrëdhënie me institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë, si dhe në marrëdhëniet teknike me institucione të huaja homologe;
 - c) nxjerr urdhra dhe udhëzime për veprimtarinë e strukturave të saj në nivel qendror dhe rajonal;
 - ç) i propozon ministrit shpërndarjen e mallrave rezervë të grupi të B;
 - d) miraton shitjen me ankand publik të mallrave të grupit C;
 - dh) vlerëson dhe urdhëron gjendjen e gatishmërisë në institucion;
 - e) kryen detyra të tjera në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

KREU IV

ADMINISTRIMI I REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

Neni 12

Financimi

Burimet e financimit për krijimin dhe administrimin e rezervave materiale të shtetit janë:

- a) Buxheti i shtetit;
- b) donacione të ndryshme financiare apo materiale;
- c) projekte të investimeve të brendshme dhe të huaja në fushën e rezervave materiale të shtetit;
- ç) burime të tjera që i lejon ligji.

Neni 13

Marrja në dorëzim

1. Procedurat dhe rregullat për marrjen në dorëzim të mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit përcaktohen me udhëzim të Kryeministrit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nuk merr në dorëzim mallra të cilat kanë tejkaluar afatin e përdorimit ose në prag të tejkalimit të këtij afati.

Neni 14

Ndihmat humanitare

1. DPRMSH-ja siguron bashkëpunimin me strukturat dhe institucionet e tjera, me qëllim kryerjen e procedurave të përsheptuara dhe të lehtësuara, sipas legjislacionit në fuqi, për marrjen në dorëzim të mallrave ndihmë humanitare që i dhurohen shtetit shqiptar, veçanërisht kur merren si pjesë e asistencës ndërkombëtare, si dhe ruajtjen e tyre në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Në rast se donatori kërkon shpërndarjen e ndihmës humanitare në favor të një individi, një komuniteti apo të një personi juridik a privat jofitimprurës të përcaktuar nga ai vetë, përgjegjëse për marrjen në dorëzim dhe administrimin e mallit, është njëësia e vetëqeverisjes vendore që përfshin në juridiksionin e saj subjektin pritës. Rregullimi i procedurave të hyrjes, administrimit dhe shpërndarjes së mallrave në këtë rast bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.
3. Mallrat ndihmë humanitare grupohen për nga natyra, funksioni dhe rëndësia në mallra të grupit A, mallra të grupit B dhe mallra të grupit C. Ato administrohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të këtij ligji.
4. Mallrat ndihmë humanitare me natyrë mjekësore që i dhurohen shtetit shqiptar merren në dorëzim përkohësisht nga DPRMSH-ja. Administrimi i tyre do të bëhet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, nga strukturat e Inspektoriatit Shëndetësor të SHPPFA-së dhe Komandës Mbështetëse, në përputhje me kapacitetet e tyre magazinuese, brenda 30 ditëve.
5. Procedurat dhe rregullat për marrjen në ruajtje dhe marrjen në dorëzim të mallrave ndihmë humanitare mjekësore përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrave që mbulojnë fushat përkatëse.
6. Për mallrat ndihmë humanitare nuk përcaktohet limiti minimum.
7. DPRMSH-ja bashkëpunon me institucionet e tjera, AKMC-në dhe strukturat e mbrojtjes civile, me qëllim ofrimin e asistencës ndërkombëtare me mallra për menaxhimin e fatkeqësive në vendet e tjera, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe në proporcion me kapacitetet e saj. Dhënia e mallrave ndihmë humanitare bëhet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit.

Neni 15

Freskimi

1. Freskimi është i detyrueshëm për mallrat rezervë materiale të shtetit në limitet e kohëruajtjes së tyre ose kur paraqitet rrezik zhvlerësimi cilësor.
2. DPRMSH-ja, në funksion të freskimit, mund të bashkëpunojë me çdo subjekt ekonomik, të hyjë në marrëdhënie kontraktore me ose pa pagesë, gjithnjë duke ruajtur standardet dhe cilësinë e mallit që freskohet me koston më të ulët.
3. DPRMSH-ja, në 3-mujorin e fundit të vitit kalendarik, harton planin e freskimit të mallrave rezervë materiale të shtetit për vitin pasardhës.

4. Freskimi i mallrave rezervë kryhet sipas planit vjetor të freskimit, të miratuar nga ministri me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit.

Neni 16

Mirëmbajtja

1. DPRMSH-ja harton dhe ndjek përmbushjen e standardeve teknike për mirëmbajtjen e rezervave materiale të shtetit.
2. Për artikujt e rezervave materiale të shtetit të cilat kërkojnë kushte të veçanta mirëmbajtjeje, DPRMSH-ja mund të kontraktojë për depozitimin e tyre subjekte ekonomike, të cilët plotësojnë kushtet e duhura teknike për të siguruar, për aq sa është e mundur, pandryshueshmërinë e gjendjes cilësore dhe vëllimore të mallrave.
3. Kostot financiare për të siguruar mirëmbajtjen e rezervave materiale të shtetit përballohen nga buxheti i shtetit.

Neni 17

Shitja

1. Shitja e mallrave rezervë materiale të shtetit bëhet kur:
 - a) nuk vendoset shpërndarja pa pagesë.
 - b) kërkohet freskimi i tyre.
2. Shitja e mallrave rezervë të shtetit, në çdo rast, duhet t'i shërbejë qëllimit të këtij ligji dhe të mos cenojë administrimin normal të tyre.
3. Shitja e mallrave rezervë shteti bëhet sipas rregullave dhe procedurave të sanksionuara në legjislacionin për ankandin publik të Republikës së Shqipërisë.
4. Të ardhurat që krijohen nga shitja e mallrave rezervë materiale të shtetit kalojnë në favor të buxhetit të shtetit.

Neni 18

Seleksionimi

Seleksionimi i artikullit rezervë materiale të shtetit bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, vetëm në rastet e avarisë së pakthyeshme ekologjike, të rrezikimit të jetës apo shëndetit, si dhe për mbrojtjen nga zhvlerësimi i menjëhershëm i artikujve të tjerë të rezervës materiale të shtetit. Seleksionimi mund të bëhet edhe për materialet e përdorura apo të dëmtuara në situatat e përshkruara në nenin 5 të këtij ligji.

KREU V

BASHKËPUNIMI

Neni 19

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e rezervave materiale të shtetit mbështetet në këtë ligj, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe dokumente të tjera, si dhe përfshin:

- a) shkëmbimin e të dhënave dhe të informacioneve rreth krijimit dhe administrimit të rezervave materiale të shtetit me autoritetet kompetente të vendeve të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare, në veçanti me vendet me të cilat ndajnë traditë të përbashkët në këtë fushë;
 - b) koordinimin e kalimit të kufirit shtetëror në rastin e marrjes dhe dhënies së mallrave ndihmë humanitare, për rastet që nuk përfshihen në pikat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të paragrafit 1, të nenit 5;
 - c) koordinimin e shpërndarjes së mallrave ndihmë humanitare në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij ligji, për rastet që nuk përfshihen në pikat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të paragrafit 1, të nenit 5;
 - ç) përgatitjen dhe organizimin e veprimtarive të ndryshme ndërkombëtare në fushën e rezervave materiale të shtetit;
 - d) përgatitjen dhe implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e rezervave materiale të shtetit;
 - dh) identifikimin e kapaciteteve për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale të shtetit, mbajtjen në gatishmëri dhe përmirësimin e tyre, duke marrë parasysh praktikat më të mira në nivelin e shteteve anëtare të BE-së dhe në nivelin ndërkombëtar në këtë fushë.
2. Marrja dhe dhënia në planin ndërshtetëror të mallrave ndihmë humanitare bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon marrjen dhe dhënien e asistencës ndërkombëtare midis shteteve dhe nenin 14 të këtij ligji.

Neni 20

Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. DPRMSH-ja bashkëpunon me institucione të tjera dhe subjekte ekonomike, me qëllim përmbushjen efektive të detyrimit të mirëmbajtjes së rezervave materiale të shtetit, si dhe çdo aktivitet në kuadër të administrimit të tyre.
2. DPRMSH-ja, përveç aktivitetit kryesor, ndërvepron me institucione të tjera, si vijon:
 - a) bashkëpunon me organet e procedimit penal, duke i asistuar me ruajtjen e mallrave të sekuestruara në cilësinë e provës materiale, në përputhje me legjislacionin penal;
 - b) bashkëpunon me institucione qendrore dhe vendore, me qëllim marrjen në dorëzim të mjeteve të kategorizuara prej tyre si të dala jashtë përdorimit;
 - c) në proporcion me kapacitetet e saj, bashkëpunon me institucione qendrore dhe vendore, duke i asistuar me mallra që u nevojiten në zhvillimin normal të aktivitetit të tyre funksional, sipas procedurave të parashikuara për shpërndarjen e mallrave.

Neni 21

Mallrat e sekuestruara

1. DPRMSH-ja ka detyrim të bashkëpunojë me organet e procedimit penal për ruajtjen e sendeve provë materiale në përputhje me legjislacionin penal, në proporcion me kapacitetet e saj dhe duke mos cenuar administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nuk mund të kryejë asnjë veprim administrimi për mallrat e sekuestruara deri në momentin kur organi kompetent vendos/urdhëron kryesisht ose me propozim të DPRMSH-së administrimin e tyre.

Neni 22

Bashkëpunimi me AKMC-në

1. DPRMSH-ja bashkëpunon me AKMC-në në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.
2. DPRMSH-ja vë në dispozicion të AKMC-së, me kërkesë të saj, një bazë të dhënash të përditësuar mbi gjendjen sasiore në kohë reale të artikujve rezervave materiale të shtetit sipas nomenklaturës përkatëse, vendvendosjen e tyre, si dhe, në rast të emergjencës civile, të dhëna të tjera mbi shpërndarjen në plan gjeografik të mallrave.
3. DPRMSH-ja dhe AKMC-ja bashkërendojnë punën, me qëllim dhënien dhe përfitimin e asistencës ndërkombëtare me ndihma humanitare, referuar parashikimeve të nenit 5 dhe 14 të këtij ligji, si dhe legjislacionit për mbrojtjen civile.
4. DPRMSH-ja bashkëpunon me AKMC-në dhe strukturat rajonale të mbrojtjes civile për të koordinuar punën për ndërhyrjen në mënyrë operative me mallra për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe shëndetit.
5. Çdo kërkesë dhe vlerësim nevojash për ndihmë në raste fatkeqësish nga institucionet qendrore dërgohet në AKMC, e cila e përcjell kërkesën në DPRMSH.
6. Çdo kërkesë dhe vlerësim nevojash për ndihmë në raste fatkeqësish nga kryetari i bashkisë, konfirmohet nga prefekti i qarkut, dërgohet në AKMC, e cila e përcjell kërkesën në DPRMSH.

Neni 23

Detyrimi për bashkëpunim në kohë rreziku

Në kuadër të marrjes së masave të jashtëzakonshme, kur verifikohen rastet e parashikuara në pikat “a”, “b” dhe “c”, të paragrafit 1, të nenit 5 të këtij ligji, me propozim të ministrit, Këshilli i Ministrave vendos detyrimin e subjekteve ekonomike private, të përcaktuar shprehimisht në vendim, të cilët ushtrojnë veprimtari prodhuese dhe/ose tregtare me artikuj të caktuar që bëjnë pjesë në nomenklaturën e mallrave rezervë materiale të shtetit, të hyjnë në marrëdhënie kontraktore me DPRMSH-në, me qëllim ruajtjen, mirëmbajtjen, plotësimin dhe/ose përtëritjen e artikullit rezervë materiale të shtetit.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore, në zbatim të pikës 2 të nenit 4, pikës 2, të nenit 5, pikës 3, të nenit 9 dhe pikës 2, të nenit 14 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor, në zbatim të pikës 1, të nenit 13 të këtij ligji.
3. Ngarkohet Ministri që brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 5, të nenit 14 dhe shkronjës “ç”, të nenit 8 të këtij ligji.

Neni 25

Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 26

Shfuqizime

Ligji nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Gramoz Ruçi